



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 02 nëntor 2020
Nr. Ref.:RK 1636/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI135/19

Parashtrues

Shkodran Hashani

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të
Republikës së Kosovës, Ac.nr.2469/15, të 4 korrikut 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shkodran Hashani, me vendbanim në komunën e Obiliqit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Ac.nr.2469/15] e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), të 4 korrikut 2019, në lidhje me Aktgjykimin [C.nr.520/09] e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 9 dhjetorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 29 gusht 2019, Kryetarja caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 2 tetor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai që ta njoftojë Gjykatën nëse para Gjykatës përfaqësohet vetë apo me përfaqësues.
8. Më 9 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës njoftoi Gjykatën se nuk ka përfaqësues dhe i njëjti përfaqësohet vetë para Gjykatës.
9. Më 29 tetor 2019, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
10. Më 12 maj 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrim të kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë dokumentet si në vijim:
 - a) Informatën nëse ekspertiza e komunikacionit e bërë në fillim të procedurës i është dërguar parashtruesit të kërkesës;
 - b) Transkriptin e seancës; dhe
 - c) Dosjen origjinale të rastit.

11. Gjykata Themelore në Prishtinë, në afatin e paraparë kohor, nuk kishte dorëzuar në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
12. Më 8 qershor 2020, Gjykata ripërsëriti kërkesën në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar që të dorëzohen në Gjykatë shkresat e lartcekura në paragrafin 10 të këtij Raporti.
13. Më 9 qershor 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi dosjen origjinale të rastit.
14. Më 7 tetor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Nga shkresat e lëndës rezulton se me 6 nëntor 2008, në magjistralen Prishtinë-Obiliq kishte ndodhur një aksident i komunikacionit ndërmjet parashtruesit të kërkesës i cili kishte qenë i punësuar tek Kompania N.N.T.SH. "Patroni" me seli në Malishevë dhe personit H.S.
16. Më 12 mars 2009, H.S. kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër i. Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës-Fondi i garancioneve për sigurime të detyruara në Kosovë, ii. N.N.T.SH. "Patroni" me seli në Malishevë dhe iii. parashtruesit të kërkesës, duke pretenduar se në bazë të raportit të policisë, dhe fotografive të automjetit të dëmtuar, është vërtetuar se aksidenti kishte ndodhur për shkak të lëvizjeve të pakontrolluara të makinës së punës të cilën e drejtonte parashtruesi i kërkesës, dhe në këtë mënyrë i kishte shkaktuar dëm material automjetit të cilin e drejtonte H.S. Përmes padisë e tij, H.S. kishte kërkuar kompensim të dëmit material në lartësi prej 1110 euro (një mijë e një qind e dhjetë euro) me kamatë ligjore nga data e aksidentit.
17. Më 17 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës përmes përgjigjes në padi kishte deklaruar se e konteston padinë sepse e njëjta nuk mund të mbështetet në procesverbalin e policisë ngase nga kjo e fundit nuk mund të dëshmohet përgjegjësia e tij në raport me rastin që kishte ndodhur. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu e konteston edhe lartësinë e kërkesëpadisë, duke pretenduar se e njëjta nuk ka bazë ligjore.
18. Më 21 nëntor 2011, Shoqata e Sigurimeve të Kosovës-Fondi i garancioneve për sigurime të detyruara në Kosovë, përmes përgjigjes në padi, kishte kontestuar padinë duke theksuar ndër të tjera *"provat e prezantuara së bashku me padinë nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për pranimin e përgjegjësisë nga ana e të paditurës [...] duke u nisur nga rregullorja për regjistrimin e automjeteve motorike pirunieri është mjet është mjet motorik i cili nuk i nënshtrohet sigurimit të autopërgjegjësisë"*.
19. Më 14 dhjetor 2011, N.N.T.SH. "Patroni", gjithashtu përmes përgjigjes në padi, kontestoi këtë të fundit me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës në kohën e kryerjes së aksidentit kishte qenë duke i kryer punët e tij personale dhe nuk ishte në orarin e punës.

20. Më 9 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C.nr.520/09] miratoi padinë e H.S. dhe e detyroi parashtruesin e kërkesës që në emër të kompensimit të dëmit material t'ia paguajë shumën në vlerë prej 896, 42 euro (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro e dyzet e dy cent) me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet për kursim me afat një vit.
21. Nga arsyetimi i Aktgjykimit dhe nga procesverbali i shqyrtimit, vërehet se parashtruesi i kërkesës ka qenë prezent në seancën e parë përgatitore ndërsa në seancën e dytë përgatitore dhe atë të shqyrtimit kryesor, parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë i pranishëm edhe pse i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt. Gjykata Themelore arsyetimin e saj e kishte mbështetur në ekspertizën e komunikacionit të 15 tetorit 2014, me të cilën vërtetohet se parashtruesi i kërkesës është fajtor, dhe ekspertizën e 27 tetorit 2014, me të cilën është vërtetuar lartësia e dëmit material të cilin parashtruesi i kërkesës ia ka shkaktuar të dëmtuarit H.S.
22. Nga shkresat e lëndës vërehet se ekspertiza e aksidentit të komunikacionit e 15 tetorit 2014 dhe ekspertiza teknike mbi vlerësimin e dëmit, e 27 tetorit 2014, i është dërguar në adresë të parashtruesit të kërkesës dhe e njëjta është pranuar nga N.H., babai i parashtruesit të kërkesës më 12 nëntor 2014 (Sqarim: Fletëkthesa për pranimin e ekspertizave është në dosjen origjinale të rastit e dorëzuar nga Gjykata Themelore).
23. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.520/09] arsyetoi se *“Gjykata i vlerësoj mendimet e ekspertit të komunikacionit dhe atë të makinerisë si vlerësim real, objektiv, të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe vendosi që mendimeve t’ua jep besimin e plotë.*
Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata vlerësoj se i padituri mban përgjegjësinë për dëmin që i është shkaktuar paditësit në automjetin e tij, gjatë aksidentit të trafikut, për çka i padituri është i obliguar që paditësit t’ia kompensojë dëmin në pajtim me nenet 154, 189 dhe 185 të LMD-së”.
24. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, me pretendimet se i njëjti ishte marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të të drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se ekspertizat të cilat janë kryer lidhur me rastin e tij nuk i janë dërguar parashtruesit të kërkesës dhe i njëjti nuk ka pasur mundësi që të deklarohej lidhur me to dhe as t’i kundërshtojë. Parashtruesi pretendon se Gjykata Themelore, në përputhje me nenin 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka qenë e obliguar, që të gjitha palëve në procedurë t’u jepet mundësia që të deklarohej lidhur me ekspertizën.
25. Më 4 korrik 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac.nr.2469/15] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe në këtë mënyrë vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.520/09] e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit në arsyetimin e saj theksoi *“aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e cila për shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës*

zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala në ankesë”.

26. Më 6 gusht 2019, Parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me propozim që të paraqet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër Aktgjykimit [Ac.nr.2469/15] të 4 korrikut 2019 të Gjykatës së Apelit duke i përsëritur të njëjtat pretendime që i kishte paraqitur në Gjykatën e Apelit.
27. Më 19 gusht 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit [KMLC.nr.135/1019] kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës, për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *”- nuk i është dhënë mundësia ligjore që të deklarohet për ekspertizën e ekspertit të komunikacionit (neni 5, 11 dhe 362 i LKP),*
 - se ekspertiza nuk i është dorëzuar për vërejtje dhe plotësime duke u udhëzuar në ndihmën juridike si palë laike (neni 11 i LPK),*
 - se rrethanat e rastit tregojnë çartë se aksidenti ka ndodhur brenda punishtes të evidentuar, e paditësi në automjet ka hy në vendpunishte dhe - për të njëjtën çështje janë zhvilluar dy procedura, sipas padisë së paditësit [H.S] dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit]”.*
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulohet vendimi i kontestuar.

Dispozitat përkatëse ligjore

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 5

5.1 Gjykata do t'i jep mundësi secilës palë që të deklarohet rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare.

5.2 Vetëm në rastet e përcaktuara me këtë ligj gjykata ka drejtë që të vendos mbi kërkesën për të cilën palës kundërshtare nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet.

Neni 11

11.1 Palën që nuk është e përfaqësuar nga avokati, gjykata e udhëzon se cilat veprime procedurale mund t'i kryejë, sa herë që konstaton se ajo nga

padijenja nuk i shfrytëzon të drejtat procedurale që i takojnë sipas këtij ligji.

11.2 Gjykata duhet ta udhëzojë edhe palën që është e përfaqësuar nga avokati për veprimet procedurale, kur konsideron se përfaqësuesi nuk është duke e kryer punën në mënyrë profesionale.

Neni 111

111.1 Po që se personi të cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës nuk gjendet në banesën e vet, dorëzimi bëhet duke iu dhënë shkresa ndonjë anëtar të rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë shkresën në dorëzim, e po që se as këta nuk gjenden në banesë, shkresa do t'i jepet fqinjit, po që se pajtohet me një gjë të këtillë. Dorëzimi i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i vlefshëm.

[...]

111.4 Personat të cilëve u është bërë dorëzimi i shkresave sipas dispozitave të sipërme të këtij neni, në vend se adresatit, kanë për detyrë që shkresën t'ia dorëzojnë këtij te fundit.

Neni 182

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në qoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejt ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

b) në qoftë se është vendosur për kërkesën e cila nuk bënë pjesë në juridiksionin gjyqësor;

[...]

g) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka bazuar vendimin e vetë në disponimin e palejueshëm të palëve, (neni 3 paragrafi 3 i këtij ligji);

i) në qoftë se ndonjëherë nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë;

j) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjek procesin në gjuhën e vet, kurse për këtë arsye ankohet;

k) në qoftë se në procedurë si paditës, ose i paditur, ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor

ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedurës apo për kryerjen e ndonjë veprimi në procedurë, në qoftë se zhvillimi i procedurës,

respektivisht ushtrimi i veprimeve të veçanta në procedurë nuk është lejuar më vonë;

[...]

m) në qoftë se, në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore;

Neni 362

362.1 Eksperti gjithmonë thirret në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.

362.2 Kopjen e aktvendimit nga neni 359 të këtij ligji gjykata ia dërgon ekspertit bashkë me letërthirrjen për në seancë kryesore.

Neni 367

Gjykata ua dërgon palëve konstatimin dhe mendimin e shkruar së paku tetë (8) ditë para se të filloj seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

33. Gjykata, më tej, i referohet neneve nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. *Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

34. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Ac.nr.2469/15] e Gjykatës së Apelit të 4 korrikut 2019, në lidhje me Aktgjykimin [C.nr.520/09] e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 9 dhjetorit 2014, pas shterrimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës i ka saktësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
35. Përveç këtyre kritereve, Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

36. Gjykata fillimisht rikujton që Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C.nr.520/09] miratoi padinë e H.S. dhe e detyroi parashtruesin e kërkesës që në emër të kompensimit të dëmit material si rezultat i aksidentit të komunikacionit të ndodhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe H.S. t'ia paguaj H.S. shumën në vlerë prej 896, 42 euro. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac.nr.2469/15] të 4 korrikut 2019, kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe kishte vërtetuar në plotni aktgjykimin e shkallës së parë. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër këtij të fundit dhe më 19 gusht 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit [KMLC.nr.135/1019], e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.
37. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se atij i është shkelur e drejta e tij kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës për dy arsye: (i) sipas

parashtruesit, ekspertiza e komunikacionit e zhvilluar në rastin e tij nuk i është dorëzuara parashtruesit të kërkesës për vërejtje, dhe (ii) parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike. Gjykata rikujton se neni 31 i Kushtetutës përcakton se:

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*

[...]

38. Gjykata edhe një herë rikujton pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], i cili në substancë para Gjykatës ankohet se gjykatat e rregullta nuk i kanë dorëzuar ekspertizën e komunikacionit të zhvilluar në rastin e tij duke theksuar se “nuk i është dhënë mundësia ligjore që të deklarohet për ekspertizën e ekspertit të komunikacionit (neni 5, 11 dhe 362 i LKP), - se ekspertiza nuk i është dorëzuar për vërejtje dhe plotësime duke u udhëzuar në ndihmën juridike si palë laike (neni 11 i LPK). Parashtruesi gjithashtu pretendon se gjykata e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike duke theksuar se “rrethanat e rastit tregojnë çartë se aksidenti ka ndodhur brenda punishte të evidentuar, e paditësi në automjet ka hy në vendpunishte”.
39. Gjykata thekson se në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
40. Lidhur me pretendimin e parë të parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta nuk i kanë dorëzuar ekspertizën e aksidentit të komunikacionit të zhvilluar në rastin e tij duke i mohuar të drejtën që të kundërshtojë ekspertizën dhe të deklarohet lidhur me te, Gjykata vëren nga dosja origjinale të cilën e ka dorëzuar Gjykata Themelore në Prishtinë, se të njëjtat i janë dorëzuar në

adresë të parashtruesit të kërkesës dhe e njëjta është pranuar nga N.H., babai i parashtruesit të kërkesës.

41. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenin 111 të Ligjit për Procedurën kontestimore i cili thekson se po që se personi, cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës nuk gjendet në banesën e vet, dorëzimi bëhet duke iu dhënë shkresa ndonjë anëtar të rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë shkresën në dorëzim.
42. Në dritën e krejt kësaj që u sqarua më lart, e bazuar në dosjen e rastit, Gjykata vëren se ekspertiza e aksidentit të komunikacionit e 15 tetorit 2014 dhe ekspertiza e vlerësimit të dëmit e 27 tetorit 2014, janë dërguar në adresë të parashtruesit të kërkesës dhe e njëjta është pranuar nga N.H., babai i parashtruesit të kërkesës më 12 nëntor 2014, dhe rrjedhimisht parashtruesi i kërkesës e ka pranuar ekspertizën e komunikacionit.
43. Për më tepër Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte qenë prezent në seancën e parë përgatitore, por jo edhe në atë të shqyrtimit kryesor ku edhe janë lexuar ekspertizat e aksidentit lidhur me rastin e tij. Lidhur me këtë, Gjykata Themelore në Prishtinë, në Aktgjykimin [C.nr.520/09] kishte theksuar *“i padituri nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë. Për këtë arsye Gjykata seancën e shqyrtimit kryesorë ka mbajtur në mungesë të të paditurit”*.
44. Rrjedhimisht Gjykata, konstaton se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është i pabazuar.
45. Lidhur me pretendimin e dytë të parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike duke theksuar se *“rrethanat e rastit tregojnë çartë se aksidenti ka ndodhur brenda punishte të evidentuar, e paditësi në automjet ka hy në vendpunishte”*, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi pretendimet për mos vërtetimin e drejtë të provave dhe fakteve, të bërë nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë.
46. Megjithatë, Gjykata ka parasysh arsyetimin e Gjykatës së Apelit në Aktgjykimin e saj [Ac.nr.2469/15] e 4 korrikut 2019, ku në lidhje me provat kishte theksuar si në vijim:

“Gjykata i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jokontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurit për kompensimin e dëmit, pastaj rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit dhe rrjedhimisht përfundimin për vëllimin e kërkesës së aprovuar Gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë edhe sa i përket dëmit që ka pësuar paditësi për shkak të aksidentit. Në këtë kuptim

vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës së komunikacionit të ekspertit Ylli Koshi, të datës 15.10.2014 si dhe ekspertizës mbi vlerësimin e dëmit mbi automjetin e paditësit, Të ekspertit Nexhmi Shala, të datës 27.10.2014 i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm. Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materiale-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesën e aprovuar në shumën sikurse në diapozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata është e mendimit se e njëjta është adekuate, e krejt kjo duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësi a e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj të dëmtuarit/këtu paditësit, satisfaksion që ai me këto mjete t'i riparoj në një masë nevojat e tij materiale si pasojë e dëmit të shkaktuar.”

47. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ dhe po ashtu edhe me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
48. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
49. Megjithatë, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetues, bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimet e dhëna në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore janë të qarta dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
50. Gjykata e Apeli gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës arsyetoi se Aktgjykimi i shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, duke e vërtetuar faktin se gjendja faktike e konstatuar nga Gjykata Themelore, është e drejtë dhe se deri te aksidenti i komunikacionit në mes të parashtruesit të

kërkesës dhe H.S. ka ardhur si pasojë e lëshimeve të parashtruesit të kërkesës dhe se i njëjti mban përgjegjësi për dëmin.

51. Në dritën e kësaj, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të të drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë (shih rastin e Gjykatës KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjokaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
52. Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
53. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
54. Si përfundim, në pajtim rregullin 39 (2) të Rregullores së punës kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 7 tetor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi